




REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO-REPUBLIKA KOSOVA  
KOMUNA E SUHAREKËS  
MUNICIPALITY OF SUHAREKA-OPSTINE SUVA REKA



ZYRA E PROKURIMIT

Nr. 057/2020

Nr. Protokolli: 110/2020

<b>Për:</b>	" Eko Term " SH.P.K., Brigada 123 pn, 23000, Suhareke
<b>Kopje:</b>	z.Bali Muharremaj, Kryetar i Komunës së Suharekës
<b>Nga:</b>	Afrim BYTYQI, u.d. Shef i Prokurimit
<b>Lënda:</b>	<b>VENDIM</b>
<b>Datë:</b>	<b>28.09.2020</b>

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Suharekës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.1) të Ligjit për Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 7 (paragrafi 7.1 pika a ) të Rregullave për Parashtrimin e Ankesave të aprovuara nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 22.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik: " Eko Term " SH.P.K., Brigada 123 pn, 23000, Suhareke lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qerdhës të femijeve në Samadraxhë-Faza e II" me Nr. të Prokurimi: 624-20-1863-5-2-1& 624-020-033-521nxjerr këtë:

## V E N D I M

- 1. Refuzohet** kërkesa për ri-shqyrtim e datës 22.09.2020 të parashtruar nga Operatori Ekonomik **Eko Term " SH.P.K., Brigada 123 pn, 23000, Suhareke** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Ndërtimi i Qerdhës të femijeve në Samadraxhë-Faza e II" me Nr. të Prokurimi: **624-20-1863-5-2-1& 624-020-033-521** Njoftim per Vendimin e AK –së, të datës 15.09.2020 të publikuar në platformen elektronike.
- 2. Vërtetohet NJOFTIMI MBI VENDIMIN E AK të publikuar me datë: 15.09.2020**
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe do të publikohet për të gjitha palët në platformën elektronike në adresën: <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.

## A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues, Komuna Suhareke me datë 22.09.2020 përmes platformës elektronike, e-prokurimi, ka pranuar kërkesë për ri-shqyrtim të aktivitetit të prokurimit "Ndërtimi i Qerdhës të femijeve në Samadraxhë-Faza e II" me Nr. të Prokurimi: **624-20-1863-5-2-1& 624-020-033-521** kundër Njoftim per Vendimin e AK –së, të datës 15.09.2020 të publikuar në platformen elektronike. Autoritetit Kontraktues pasi shqyrtoi dhe analizoi kërkesen tuaj, vlerëson se nuk ka bazë për shkelje të procedurave ligjore të prokurimit publik gjatë vlerësimit të tenderëve, dhe se komisioni për vlerësim dhe krahasim të tenderëve, konform dispozitave ligjore të Ligjit të Prokurimit Publik dhe RRUOPP, dhe Vendimit të OSHP-së, ka kërkuar sqarime shtesë me date 07.09.2020 për pozicionet me çmime normalisht

të ulët, dhe pas marrjes së përgjigjes nga OE Age Group, Komisioni për vlerësim propozon zyrën e Prokurimit për shpallje të fituesit për këtë aktivitet.

Andaj bazuar në të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së.  
Ankesa pranë OSHP-së duhet të dorëzohet brenda 10 (dhjetë) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.

u.d. Shef i Prokurimit  
Atim BYTYQI

